



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA SHTIME
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Shërbime Publike
Uprava za Javne Službe/Directorate of Public Service

Nr.prot.08/07

Datë 24.02.2025

**PROCESVERBAL NGA DISKUTIMI PUBLIK ME QYTETARË PËR DRAFT-PLANI
NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR
RAJONIN E GJILANIT DHE FERIZAJT**

E mbajtur më datë 11 Shkurt 2025 (e martë) duke filluar nga ora 14:00 në Sallën e Kuvendit të Komunës së Shtimes

Pjesëmarrës në takim ishin Drejtori i Drejtorisë për Shërbime Publike, Bardhyl Rushiti, zyrtarë komunal dhe qytetarë

Mbledhja është hapur nga **Bardhyl Rushiti Drejtor për Shërbime Publike** i cili para të pranishmëve prezantoi qëllimin e takimit.

Bardhyl Rushiti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, ashtu si jeni njoftuar sot po mbahet dëgjimi publik për draft Planin Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, draft ky i cili i është prezantuar Kuvendit të Komunës së Shtimes dhe i njëjti ka vendosur që ta dërgojë në diskutim publik e pastaj pas diskutimit publik të dërgohet për miratim. Ky plan ka për qëllim që të fillohet me një hap të ri të trajtimit të mbetjeve si nga ndërtim demolimi poashtu edhe të mbeturinave të amvisrisë duke aplikuar metodat e Riciklimit dhe të Kompostimit. Me këtë rast po e hap edhe diskutimin për të pranishmit në sallë.

Hysen Hoxha-Qytetar: Fillimisht uroj komisionin që e ka realizuar punën në përgatitjen e këtij plani i cili synon të reduktoj mbeturinat dhe të krijoj një mjedis të pastër për të gjithë. Unë si qytetar dëshiroj që këto plane të kenë zbatimin e duhur në teren dhe qytetarëve të ju ofrohet një mjedis më i pastër e jo çdo vend të shofim hudhje të mbeturinave duke na krijuar deponi ilegale.

Nuk kishte diskutime tjera nga të pranishmit andaj Drejtori për Shërbime Publike Bardhyl Rushiti i falënderoj të pranishmit dhe i siguroj që ky plan do të bëjë zgjidhje të qëndrueshme sa i përket mbeturinave.

Takimi përfundoi në ora 14:45

Procesmbajtës:
Albulenë Emini

**LISTA E PJESËMARRËSVE PËR KONSULTIMIN PUBLIK PËR DRAFT-PLANIN
NDËRKOMUNAL PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË MBETURINAVE PËR RAJONIN E
GJILANIT DHE FERIZAJT**

Shtime, 11 shkurt 2025

Nr.	Emri dhe mbiemri	Institucioni	Nënshkrimi
1	HUSEN HOKHA	AFIDIENTAGIST	Hokha H.
2	YMERI BEHÇOLI	Z. KOMUNAL	Ymeri B.
3	Ilir Fejzullahu	Z. KOMUNAL	Ilir F.
4	ABDULENE GINI	K. SHITIME	Abdulenë G.
5	HAKSHIR SHABANI	K. SHITIME	Hakshir S.
6	Skender Daci	K. SHITIME	Skender D.
7	Vlora Hyse	K. SHITIME	Vlora H.
8	Arben Topalli	K. SHITIME	Arben T.
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			

